



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A Group" Sh.P.K. të datës 13.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A Group" Sh.P.K. e datës 13.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik "2A Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "2A" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 13.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 06.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** “Ne si Operator Ekonomik me datë 11.07.2023 kemi pranuar njoftimin për kontratë të emërtuar me titull “Ndërtimi I shkollës në lagjen Kalabria me nr.Prokurimit 616-23-6340-5-1-1, ku është kërkuar tek KUSHTET PËR PJESËMARRJE, më konkretisht tek Kapaciteti Teknik dhe profesional kërkesa 2.Kualifikimet shkollë dhe profesionale të personelit udhëheqës. · Inxhinier i Arkitekturës 1, me master profesional për efikasitet energjetike me përvojë min. 7vite · Specialist i mjedisit 1, i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi, duhet të ketë të paktën një diplomë bachelor me min pesë vjet përvojë në një natyrë të ngjashme, · Inxhinier i diplomuar i makinerisë 1, me së paku 7 vite përvojë punë pas diplomimit, dhe të jetë i certifikuar në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë · Inxhinier i diplomuar i makinerisë-me përvojë minimum 5 vite dhe të jetë i certifikuar. Shënimi për kërkesat e aftësive teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se): Paragrafi 6 Pika 6.1 kualifikimet shkollë dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore: · Inxhinier i Arkitekturës nuk ka nevojë të jetë i kufizuar me master profesional për efikasitet energjetike por mund të jetë edhe i certifikuar si auditor i energjisë · Specialist i mjedisit i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi-edhe pse pas kërkesës për rishqyrtim nga ana e Eco Logic keni dhënë sqarim se qendron dallim në mes të inxhinierit i ndërtimit dhe inxhinierit të mjedisit dhe se përshkak të natyrës së punës inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i certifikuar si specialist mjedisi atëherë lind pyetja me qfarë pune do të mirret inxhinieri i mjedisit , mu përshkak të natyrës së punës atëherë duhet ndare puna e inxhinierit të ndërtimit nga ajo e mjedisit sepse inxhinier mjedisi në këtë rast vetëm se është shumë me i kualifikuar se sa inxhinieri i ndërtimit i certifikuar si specialist mjedisi, prandaj duhet rishikuar kjo kërkesë sepse le të nënkutohet të jetë tendencioz · Specialist i mjedisit i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi-eshtë plotësisht tendencioz kur në kërkesën tjetër është kërkuar inxhinier mjedisi e që në këtë rast vetëm se është shumë me i kualifikuar se sa të jetë i certifikuar si specialist mjedisi · Inxhinier i diplomuar i makinerisë të jetë i certifikuar në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, edhe në këtë kërkesë konsiderojmë se është tendencioze sepse mund të kërkohej njëri nga stafi të jetë i certifikuar në lëmin e mbrojtjes nga zjarri e jo pikërisht inxhinieri i makinerisë sepse sipas LIGJI NR. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI dhe Udhezimit administrativ NR 25/2012-MPB , Nr 16/2017-MPB, Nr 12/2017, ku është e specifikuar se certifikues në lëmin e mbrojtjes nga zjarri mund të jenë personat me përgaditje profesionale të drejtimit teknik, mbrojtjes nga zjarri , makinerisë, elektroteknikes, teknologjisë, ndërtimit dhe arkitekture · Inxhinier i diplomuar i makinerisë-me përvojë minimum 5 vite dhe të jetë i certifikuar me standardet EN 9606-1 -ky certifikim kërkohej për saldues por jo për inxhinier Konsiderojmë se këto kërkesa janë të vendosura në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit dhe në kundërshtim me Rregullat dhe Udhezuesin Operativ për Prokurimin Publik përkatësisht neni 69, ngase janë kritere tendencioze që kufizojnë apo eliminojnë konkurrencën. Andaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndryshojë këto kritere të dosjes së tenderit sepse është në kundërshtim me LPP-në Neni 4, paragrafi 4.4 pika 1 Konkurrenca dhe pika 3, Drejtësia/Mos-diskriminimi”.

**Lidhur me pretendimet ankimore** – fillimisht duhet sqaruar se përmes nenit 59 paragrafit 59.1 të RRPP është përcaktuar se “Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlihen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit”. Në rastin konkret asnjë nga pretendimet ankimore të parashtruesit nuk kanë të bëjnë me aktivitetin përkatës të prokurimit “Ndërtimi i



therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1"). Me fjalë të tjera pretendimet ankimore i referohen një aktiviteti krejt tjetër të prokurimit (*Ndërtimi I shkolles ne lagjen Kalabria me nr.Prokurimit 616-23-6340-5-1-1*) dhe ky fakt mund të konfirmohet nga formulimi i vet pretendimeve ankimore. Kjo nënkupton ndër të tjera që pretendimet ankimore të parashtruesit nuk janë paraqitur në përputhje me nenin 59 paragrafin 59.1 të RRPP (pasi që kanë të bëjnë me dosjen e tenderit të një aktiviteti tjetër të prokurimit dhe jo me dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit ku është paraqitur kërkesa për rishqyrtim). Në këtë drejtim përmes nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit b) të RRPP është përcaktuar se "*Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore*". Për këtë arsye kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.